



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 523/1 prot.

Tiranë, më 28.03.2022

V E N D I M

Nr. 62, Datë 28.03.2022

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 176, datë 28.09.2021, të M.K kundër Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier (DRAP Fier), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak¹ të “etnisë²” dhe “gjendjes martesore³”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Ka filluar punë në arsim në datë 03.09.1990, si mësuese në profilin Histori-Gjeografi. Në datë 23.09.1999 është transferuar si mësuese në shkollën “Alush Grepcka”, Roskovec. Me Vendimin nr. 16, datë 05.11.2018, të Drejtorisë Arsimore Rajonale Fier (DAR Fier), është komanduar si drejtoreshë në këtë shkollë deri në përfundim të procesit të konkurimit. Marrëdhëniet e saj me drejtuesen e DAR Fier, Y.B kanë qenë shumë të mira. Kur u krijuan Zyrat Vendore Arsimore (ZVA) dhe Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar (DRAP) Fier, për të filluar problemet. Nga ana e DRAP Fier shikohej njëanshmëri të qëndrimit ndaj saj, për shkak të masave të ndryshme disiplinore që u morën. Me Vendimin nr. 05, datë 28.01.2020, DRAP Fier

¹ Në formularin e ankesës, M.K ka pretenduar diskriminim për shkak të gjinisë, etnisë, gjendjes arsimore dhe martesore. Me e-mail-in datë 15.02.2022, ajo ka kërkuar që ankesa të shqyrtohej vetëm për shkak të etnisë dhe gjendjes martesore.

² Referuar Vërtetimit nr. 1223, të lëshuar nga Shoqata Bashkimi i Vllahëve të Myzeqesë Apollonia, vërtetohet se M.K është me origjinë Vllahë Greke.

³ Referuar Certifikatës Familjare nr. 000942201, datë 03.02.2021 të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile 155, Roskovec, M.K është e divorcuar dhe pa fëmijë.

ka vendosur masën disiplinore “Qortim” me pretendimin se: “Numri i mësuesve ishte më i lartë se numri i orëve mësimore në profil”. Ankuesja informon se, parashikimi i kuadrit bëhet në muajin qershor dhe miratimi bëhet në muajin gusht, ndërkohë që kuadri është miratuar dhe mësuesit janë paguar për muajin shtator, nga ZVA Roskovec. Në datë 04.10.2020, DRAP Fier ka kryer takim me drejtuesit e shkollave të ZVA Roskovec për rakordimin e kuadrit (gjë që duhej të ishte bërë në muajin gusht). Me Vendimin nr. 68, datë 09.10.2020, DRAP Fier ka vendosur marrjen e masës disiplinore “Paralajmërim për pushim nga puna”, për kryerje të veprimeve në kundërshtim me Dispozitat Normative 2013, të shfuqizuar, etj. Ankuesja informon se në muajin qershor 2020 ishte lajmëruar mësuesja, M.K për zgjidhjen e kontratës së punës sipas kërkesës së drejtueses së ZVA Roskovec, B.C, pasi mësuesja nuk kishte dokumentacionin e duhur për të vazhduar punën si mësuese e profilit “Edukim Fizik”, pasi ishte me arsim parashkollor. Pas interpretimit të dokumentacionit të mësueses, DRAP Fier dhe ZVA Roskovec kthyen përgjigje me shkresë se duhet të vazhdonte procedurën për zgjidhjen e kontratës së punës së mësueses M.K. Në tetor drejtuesja e ZVA Roskovec, i ka kërkuar në mënyrë verbale që të mos vazhdonte procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës me mësuesen. Ankuesja informon se në datë 03.12.2020 e ka marrë në telefon A.K, nga MAS, i cili i ka kërkuar ndalimin e zgjidhjes së kontratës së mësueses së sipërpërmendur. Ankuesja shprehet se i ka kërkuar shkresë zyrtare për ndalimin e procedurës dhe i ka dërguar gjithë dokumentacionin e mësueses, nëpërmjet aplikacionit WhatsApp, por nuk ka marrë përgjigje. Në datë 16.12.2020, është zhvilluar një inspektim nga DPAP Tiranë. Grupi i inspektimit pasi ka kontrolluar dokumentacionin e kërkuar, ka ngritur pretendimin se dokumentet nuk ishin në cilësinë e duhur dhe ka lënë rekomandimin për të rregulluar dokumentacionin. Me shkresën nr. 45/1, datë 14.01.2021, DRAP Fier e ka njoftuar për zgjidhjen e njëanshme të kontratës së punës. Ankuesja informon se me kërkesën datë 19.01.2021, drejtuar DRAP Fier, ka kërkuar dorëheqjen nga pozicioni si drejtuese dhe kalimin si mësuese në profilin Histori-Gjeografi, por nuk ka marrë përgjigje. Në datë 26.01.2021, DRAP Fier i ka dërguar njoftimin e dytë, pasi nuk ishte paraqitur në takim për arsye shëndetësore. Në datë 05.02.2021 në shkollën “Alush Grepcka” është bërë monitorim nga ZVA Roskovec, për praktikën profesionale 1-vjeçare në profesionin e rregulluar të mësuesit. Atë ditë, ajo si drejtuese e shkollës ka qenë në vetizolim, e vërtetuar me dokumentin e mjekut, ndërsa mësuesja mentore që u monitorua ishte me ditë pune në një shkollë tjetër, ndërkohë që grupi i inspektimit ka dhënë rekomandime lidhur me inspektimin e bërë. Ankuesja ngre dyshimin se si arriti në rezultatet e nxjerra ZVA Roskovec, kur asnjë prej të monitoruarve nuk ishte në institucion. Me shkresën nr. 244, datë 22.02.2021, është njoftuar për herë të tretë për tu paraqitur në takim në datë 26.02.2021, lidhur me marrëdhëniet e punës. Në datë 04.03.2021 është paraqitur në zyrën e drejtores së DRAP Fier, e cila i ka komunikuar zgjidhjen e kontratës së punës”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 176, datë 28.09.2021, të bërë nga M.K, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1316/2, datë 08.10.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, DRAP Fier, për ankesën e bërë nga M.K si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të plotë të procedurës së verifikimit të shpërndarjes së ngarkesës mësimore në ZVA Roskovec dhe dhënies së masës disiplinore “Qortim” për ankuesen M.K në datë 28.01.2020. Kopje të kundërshtimit të ankueses dhe përgjigjes së dhënë (nëse ka).
 - Informacion nëse është marrë masë disiplinore për ndonjë drejtues tjetër për shkak të shpërndarjes së ngarkesës mësimore. Nëse po, kopje të procedurës.
 - Kopje të plotë të procedurës së dhënies së masës disiplinore “Paralajmërim për largim nga puna” për ankuesen M.K, në datë 09.10.2020. Kopje të kundërshtimit të ankueses dhe përgjigjes së dhënë (nëse ka).
 - Informacion nëse është marrë masë disiplinore për drejtues të tjerë, për të njëjtat shkelje si ankuesja. Nëse po, kopje të procedurës.
 - Kopje të plotë të akteve shkresore të verifikimit dhe trajtimit të rastit të mësueses M.K.
 - Kopje të plotë, lidhur me inspektimin e zhvilluar nga DPAP Tiranë në datë 16.12.2020 dhe informacion nëse janë zhvilluar inspektime me të njëjtën tematikë dhe në shkolla të tjera. Nëse po, kopje të raportit të vlerësimit.
 - Kopje të procedurës së monitorimit të praktikës profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit, të zhvilluar në shkollën “Alush Grepcka” nga ZVA Roskovec dhe informacion nëse ky monitorim është zhvilluar dhe në shkolla të tjera. Nëse po, kopje të raportit.

- Kopje të shkresës nr. 15, datë 19.01.2021, të bërë nga M.K, në të cilën ka kërkuar dorëheqjen nga pozicioni si drejtues dhe kalimin si mësues dhe përgjigjes së dhënë nga DRAP Fier.
- Informacion për drejtues të tjerë të cilëve i është pranuar kërkesa për të kaluar si mësues.
- Kopje të plotë të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës me M.K.
- Kopje të procedurës së emërimit të drejtuesit të ri të shkollës “A.Grepcka”.
- Kopje të Rregullores së Brendshme të shkollës “Alush Grepcka”, të ZVA Roskovec dhe të DPAP Fier.

Me shkresën nr. 1175/1, datë 21.10.2021, DRAP Fier, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Së pari, me Vendimin nr. 5, datë 28.01.2020 “Për marrjen e masës disiplinore”, në vijim të rekomandimeve të lëna në Raportin nr. 491/2, datë 01.11.2019, M.K i është dhënë masa “Qortim” për arsyet se: 1. Nuk ka shpërndarë ngarkesën mësimore sipas Udhëzimit nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat mësimore në institucionin arsimor parauniversitar”. 2. Numri i mësuesve që duhen në institucionet arsimore (IA) nuk është në përputhje me numrin e nxënësve, pasi numri i mësuesve është më i lartë se numri i orëve mësimore në profil (profili gjuhë - letërsi në 45 orë ka 4 mësues dhe 1 nëndrejtor).*

Së dyti, në vijim të dy inspektimeve të kryera në IA “Alush Grepcka”, referuar shkeljeve të konstatuara të kryera nga titullari i IA-së, është propozuar masë administrative për titullarin e shkollës në raportet e inspektimit të kryera nga DRAP Fier dhe në vijim me Vendimin nr. 68, datë 09.10.2020, ndaj M.K është dhënë masë administrative “Paralajmërim për largim nga puna”. Referuar përcaktimeve të Komisionit të Disiplinës për trajtimin e shkresës nr. 449/4, datë 10.09.2020 dhe shkresës nr. 760, datë 22.09.2020, raporte vlerësimi të DRAP Fier, si dhe pas dëgjësës me drejtoreshën e shkollës 9-vjeçare “Alush Grepcka”, ZVAP Roskovec rezultoi si më poshtë: “Bazuar në raportin e vlerësimit të protokolluar me nr. 760, datë 22.09.2020, mbi zbatimin e akteve ligjore për dokumentacionin në ruajtje të përhershme dhe raportit nr. 449/4, datë 10.09.2020, mbi shqyrtimin e ankesës së nxënësve të klasës së 9-të, lidhur me shpërndarjen e dëftesave nga drejtuesja me pagesë në shkollën 9-vjeçare “Alush Grepcka” Roskovec, janë të cilësuar rekomandimet e lëna për drejtorinë e shkollës si dhe janë lënë rekomandime për DRAP Fier që të merrte masë për drejtuesen e shkollës 9-vjeçare “Alush Grepcka”, për shkeljet ligjore të konstatuara nga ekipet vlerësuese. Me shkresën nr. 760, datë 01.10.2020 të titullares së DRAP Fier, për shqyrtimin e masës së rekomanduar sipas raportit të DRAP Fier, i është kërkuar komisionit të disiplinës të trajtojë rastin në fjalë. M.K, është thirrur për t’u dëgjuar nga anëtarët e Komisionit të Disiplinës, dëgjësë e zhvilluar në zbatim të një procedure të rregullt ligjore, ku është mbajtur dhe procesverbal i cili pasi është lexuar, është firmosur nga M.K. Gjatë dëgjësës, M.K deklaroi se do të dërgonte dokumentacionin që dispononte për t’u marrë në shqyrtim nga Komisioni i Disiplinës, lidhur me problematikat e hasura nga grupet e inspektimit të DRAP Fier, dokumentacion i dërguar në rrugë zyrtare nga drejtuesja e institucionit në fjalë, dhe protokolluar me nr. 816/2, datë 06.10.2020. Për sa më sipër rezultoi

se, prezantimi i ngjarjes së datës 30.06.2020 në shkollën 9-vjeçare “Alush Grepcka” nga ana e drejtores së shkollës në ankesën e datës 06.10.2020, dëshmon për disa problematika të cilat grupi i inspektimit nuk i ka paraqitur në raportin e vlerësimit me nr. 449/4, datë 10.09.2020. Në këtë prezantim drejtorja e shkollës pranon se nxënësit kanë hyrë me forcë në mjediset e brendshme të institucionit arsimor, pavarësisht pranisë së mësuesve kujdestarë dhe rojes së shkollës, në një periudhë kur shkolla ishte e mbyllur për shkak të masave anti-COVID dhe grumbullimet masive ishin të ndaluara. Megjithë përpjekjet që deklaroi drejtorja e shkollës, se janë bërë për t’i larguar nxënësit, përsëri një grup prej tyre kanë kryer akte vandalizmi në mjediset e brendshme dhe janë larguar pa u identifikuar. Pra, asnjë mësues dhe as roja i shkollës nuk ka monitoruar mjediset e brendshme të ndërtesës për orë të tëra, deri sa u konstatuan dëmtimet e derës dhe bazës materiale të klasës. Një ngjarje e këtyre përmasave në një institucion arsimor është trajtuar si e parëndësishme, aq sa dhe procesverbali për dëmtimet e konstatuara nga aktet vandale të nxënësve është mbajtur një ditë më vonë. Organizmat në shkollë, si bordi i shkollës, këshilli i prindërve, qeveria e nxënësve, të cilave mund t’u lihej edhe nisma e rregullimit të klasës, nuk shfaqen dhe nuk funksionojnë në këto raste, por rregullimi i mjediseve dhe zhdëmtimi organizohen, siç thuhet “prej vetë nxënësve” në një mënyrë të fshehtë, pa mbikëqyrjen e mësuesve, të prindërve, jashtë vëmendjes së institucionit arsimor, duke grumbulluar edhe kontribute financiare, për të cilat nuk dihet si administrohen. Ky organizim paralel me organizmat e ligjshme të shkollës ndodh shpesh dhe kjo për drejtoreshën është normale. Madje, nën dijeninë e plotë të drejtores së shkollës, bordi i këtij institucioni ka hequr dorë vullnetarisht nga një e drejtë e tij për të grumbulluar dhe administruar kontribute dhe dhurime të vlerave monetare duke mundësuar dhe bërë të nevojshme ndërmarrjen “vullnetare” nga ana e nxënësve, “vetëmenaxhimit” të situatave nga nxënësit e rritur. Në këto rrethana, drejtorja e shkollës nuk këmbëngul për identifikimin e dëmtuesve të shkollës, por, siç del në video, është dakord me të gjithë veprimet e ndërmarra (edhe për kontributet financiare të nxënësve) duke e kushtëzuar dhe justifikuar me detyrimin e nxënësve për të rregulluar dëmtimin e mjediseve. Drejtorja e konsideron të pranueshëm faktin që nxënësit nuk bashkëpunojnë për identifikimin e dëmtuesve të mjediseve të shkollës. Thënie se “nuk isha në dijeni se çfarë kishin organizuar nxënësit” dëshmojnë së paku, për mungesë të kontrollit mbi çka ndodh në shkollë, duke e lidhur me pohimin se “ka patur raste kur nxënësit e klasave të rritura e kanë menaxhuar vetë situatën brenda klasës si rasti i sipërpërmendur me mirëkuptim me njëri-tjetrin”. Qëndrimi i drejtores së shkollës gjatë incidentit të datës 30.06.2020, në mjediset e brendshme të shkollës “A.Grepcka” Roskovec, si dhe justifikimi i kësaj praktike si të zakonshme dhe normale, vlerësohet tërësisht i papërgjegjshëm. Referuar dokumentacionit të dërguar nga M.K të protokolluar me tonën me nr. 816/2, datë 06.10.2020, bashkëlidhur ndodhen akte shkresore të cilat provojnë gjendjen shkresore të institucionit që titullarja e institucionit ka marrë në dorëzim, problematika të cilat nuk i ka parashtruar në organet eprorë. Për sa më sipër, Komisioni i Disiplinës bazuar në nenin 37, nenin 203 të Kodit të Punës, në “Dispozitat normative për sistemin arsimor parauniversitar” të shfuqizuara me Urdhërin nr. 31, datë 28.01.2020 “Miratimi i rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore paruniversitare në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 106, Kreu XVIII të këtij të fundit, si dhe bazuar në

Udhëzimin nr. 29, datë 25.03.2007 “Për grumbullimin, ruajtjen dhe përdorimin e të ardhurave nga prindërit e nxënësve të shkollave të arsimit parauniversitar” dhe Udhëzimin nr. 25, datë 25.07.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të IA”, unanimisht vendosi që ndaj M.K, drejtores në shkollën 9-vjeçare “Alush Grepcka” Roskovec, të jepet masa disiplinore “Paralajmërim për largim nga puna”.

Së treti, në vijim të shkeljeve të konstatuara sipas Raportit të vlerësimit të DPAP Tiranë nr. 3530/8, datë 08.01.2021, nga ku është rekomanduar marrja e masave administrative ndaj titullares së IA-së, duke qenë se për M.K ishte në fuqi masa “Paralajmërim për largim nga detyra”, filloi procedura e zgjidhjes së kontratës së punës konform përcaktimeve ligjore të Kodit të Punës. Referuar dokumentacionit, rezulton se procedura për M.K ka nisur me njoftimin nr.45/1, datë 14.01.2021 dhe njoftime të tjera në vijim, pasi M.K na informonte pas çdo njoftimi, që ishte në pamundësi të paraqitej pranë DRAP Fier.

Lidhur me pretendimet e ankueses dhe kërkesave të Komisionerit, informohet se:

Së pari, rakordimi i kuadrit për vitin 2019 është bërë nga DRAP Fier, në datë 04.10.2019, sepse institucioni u krijua në datë 22.05.2019 dhe në atë periudhë funksiononte me vetëm 4 punonjës, ndërsa në vitin 2020 rakordimi i kuadrit është bërë me datë 01.09.2020 dhe jo në datë 04.10.2020.

Së dyti, M.K nuk ka paraqitur kundërshtime në lidhje me Raportet e Vlerësimit apo masat disiplinore të marra ndaj saj, në vijim të rekomandimeve të lëna në Raportet e Vlerësimit.

Së treti, bashkëlidhur gjeni procesverbalin nr. 40/1, datë 20.01.2020 mbajtur nga Komisioni i Disiplinës për dhënien e masës disiplinore drejtorit të IA “Mihal Naka” Fierseman, R.Th, i cili nuk ka shpërndarë ngarkesën mësimore dhe nuk ka kryer lëvizjen paralele të detyruar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Së katërti, me shkresën nr. 1282, datë 01.06.2020 është dërguar nga DPAP, Raport Vlerësimi i inspektimit të kryer në shkollën 9-vjeçare “15 Tetori” Vlorë, ku një ndër qëllimet ishte vlerësimi i zbatimit të Udhëzimit nr. 29, datë 25.03.2007 “Për grumbullimin ruajtjen dhe përdorimin e të ardhurave nga prindërit e nxënësve të shkollave të arsimit parauniversitar”. Në këtë raport është lënë për DRAP Fier, rekomandimi për marrjen e masës për drejtuesen e IA “15 Tetori” Vlorë. Për këtë shkelje, si dhe për çështje të tjera të kryera nga drejtuesja e IA është marrë masa e zgjidhjes së menjëhershme e kontratës së punës.

Së pesti, referuar rastit të mësueses M.K, DRAP Fier, në kthim përgjigjen e dërguar është shprehur se për kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për t'u punësuar si mësues në profilet përkatëse duhet të referohen në aktet ligjore përkatëse.

Së gjashti, nga DPAP është zhvilluar inspektimi me të njëjtën tematikë në shkollën “Adem Vrapit” Roskovec, në vijim të të cilit, me Raport Vlerësimi nr. 3530/10, datë 22.01.2021 është lënë rekomandimi, për DRAP Fier, për marrjen e masës disiplinore ndaj drejtores së IA

“Adem Vrapi”. Për këtë arsye, Komisioni i Disiplinës në DRAP Fier ka marrë masën “Qortim”, pasi ndaj saj nuk kishte masa të tjera të mëparshme.

Së shtati, referuar kërkesës së ankueses të datës 19.01.2021 për dorëheqje nga detyra si drejtoreshë dhe kalimit si mësuese, kjo kërkesë nuk mund të përmbushej në kushtet kur për M.K, është rekomanduar marrja e masave administrative si titullare e IA-së dhe ajo kishte marrë tashmë njoftimin, për zgjidhjen e njëanshme të kontratës së punës”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 176, datë 28.09.2021, Komisioneri me shkresën nr. 1316/4, datë 14.12.2021 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 21.12.2021, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Informacion për drejtues të tjerë të institucioneve arsimore të cilëve i është pranuar kërkesa për të kaluar si mësues.
 - Kopje të procedurës së emërimit të drejtuesit të ri të shkollës “A.Grepcka”.
 - Kopje të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kopje të akteve nëse është kundërshtuar vendimi.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: subjektit ankues, M.K dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësuesit me autorizim nr. 1175/3, datë 20.12.2021, të DRAP Fier, Xh.H, me detyrë specialiste e burimeve njerëzore në DRAP Fier.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftuan palët se seanca dëgjimore do të regjistrohej dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me e-mail me KMD-në.

Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesja e DPAP Fier dorëzoi shkresën nr. 1175/4, datë 20.12.2021 në të cilën në mes të tjerash informohet se: *“Së pari, informojmë se bazuar në përcaktimet ligjore të Udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit dhe të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, cilësohet se drejtuesit e DRAP-eve nuk mund të pranojnë dorëheqjen e drejtorëve dhe nëndrejtorëve të institucioneve arsimore parauniversitare pa i sistemuar më parë në vende të lira pune dhe me ngarkesë të plotë brenda të njëjtës ZVAP-je dhe rastet e dorëheqjeve të drejtorëve dhe nëndrejtorëve i të IA-ve, me kërkesë për sistemim për mësues, i paraqiten menjëherë komisionit të lëvizjeve paralele në ZVAP, gjatë apo ndërmjet viteve shkollore. Informojmë se në momentin e paraqitjes së kërkesës për dorëheqje dhe sistemimin si mësues nga ana e një drejtuesi të institucionit arsimor, DRAP Fier i drejtohet me kërkesë për informacion në lidhje*

me vendet e lira në profilin përkatës të atij drejtuesi, Komisionit të Lëvizjeve Paralele në ZVAP-në përkatëse. Në rast se Komisioni i Lëvizjeve Paralele konfirmon vendin e lirë në atë profil, procedohet me miratimin e kërkesës për dorëheqje. Bashkëlidhur ju përcjellim procedurën për miratim të dorëheqjes H.L, ish drejtues në shkollën Çermë-Shkumbin, rasti i të cilit është në kushtet e zakonshme të paraqitjes së kërkesës për dorëheqje të përcaktuara në aktet ligjore dhe jo si në rastin e M.K, ndaj të cilës kishte filluar tashmë procedura e zgjidhjes së kontratës së punës në momentin që paraqiti kërkesën për dorëheqje.

Së dyti, lidhur me kërkesën për dorëheqje nga pozicioni i drejtuesit dhe sistemimin si mësuese të paraqitur nga M.K në datën 19.01.2021, periudhë gjatë së cilës kishte nisur procedura e njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, DRAP Fier i ka dërguar kërkesë për informacion në lidhje me vendet e lira në profilin historik dhe gjeografi, Komisionit të Lëvizjeve Paralele në ZVAP Roskovec dhe nga ana e Komisionit të Lëvizjeve Paralele është dërguar informacioni se nuk kishte vende të lira në atë profil. Pra, edhe pse ka qenë në proces, zgjidhja e kontratës së punës për shkaqe të arsyeshme, DRAP Fier e ka konsideruar këtë mundësi të kërkuar nga M.K, por ZVAP Roskovec nuk ka patur vende të lira në profilin historik dhe gjeografi, në mënyrë që M.K të mund të sistemohej si mësuese.

Së treti, lidhur me emërimin e drejtuesit të ri të shkollës “Alush Grepcka”, informojmë se, bazuar në përcaktimet ligjore të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik”, i ndryshuar, kreu I, seksioni E, pika 2, ku cilësohet se: “Kur vendi i drejtorit të IPAP, shpallet i lirë, drejtori i DRAP cakton nëndrejtorin e këtij institucioni ose një mësues të IPAP, në rastin kur nuk ka nëndrejtor, për drejtimin e përkohshëm të institucionit, deri në përfundim të procesit të konkurimit”, në momentin që vendi i drejtorit në shkollën “Alush Grepcka”, mbeti vakant, nëndrejtori i këtij institucioni me Vendimin nr. 27, datë 10.03.2021 “Për delegim kompetencash”, u emërua përkohësisht në pozicionin e drejtuesit të shkollës”.

Gjatë seancës dëgjimore ankuesja i qëndroi të gjitha pretendimeve të bëra të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe theksoi⁴ se pasojat e largimit të saj nga puna janë bërë për shkak se drejtuesja e ZVAP Roskovec dhe DRAP-it Fier, nuk donin një drejtuese shkolle qyteti, me origjinë greke.

Në vijim ankuesja me shkresën, protokolluar me tonën me nr. 1775, datë 29.12.2021, dërgoi sqarime të deklarimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore.

Në vijim të detyrave të lëna gjatë seancës dëgjimore, DRAP Fier me shkresën nr. 109, datë 14.01.2022, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Së pari, lidhur me dhënien e masës së parë disiplinore “Qortim”, bashkëlidhur dokumentet e kërkuara, duke bërë me dije se edhe pas konstatimit të më shumë sesa një shkelje (katër), nga Komisioni i Disiplinës është marrë vetëm masa Qortim. Referuar nenit III, Kreu XIX të Dispozitave Normative për Arsimin

⁴ Referuar deklaratës së bërë, min. 01.15.30.

Parauniversitar, (tashmë shfuqizuar) ku cilësohet se: “Masat që komisioni i disiplinës vendos për drejtorin, janë: a) Qortim; b) Vërejtje; c) Paralajmërim për largim nga puna”, në rastin konkret i është dhënë masa disiplinore më e lehtë.

Gjithashtu, lidhur me numrin e nxënësve të regjistruar në shtator në shkollën “Alush Grepcka”, Roskovec në vitin mësimor 2019-2020, nga informacioni që zotëron DRAP Fier, rezulton se është deklaruar nga M.K në datën 10.09.2019 se janë regjistruar në total 289 nxënës në arsimin fillor dhe 220 nxënës në arsimin e mesëm të ulët, ku në klasën e dytë figurojnë 67 nxënës të regjistruar. Në datën 18.10.2019 në kontrollin e bërë nga DRAP Fier për miratimin e organikave është deklaruar nga M.K se numri i nxënësve në këtë datë është 498 nxënës, ku 62 prej tyre rezultojnë të regjistruar në klasën e dytë dhe se janë larguar me shpërngulje 5 nxënës. Me shkresën nr. 08, datë 21.01.2020, M.K ka dërguar në DRAP Fier tabelat me numrin e nxënësve të regjistruar në datën 16.09.2021, ku deklaroi se numri i nxënësve të regjistruar është 512 dhe numri i nxënësve të regjistruar për klasën e dytë është 65. Gjithashtu bashkëlidhur shkresës nr. 08, datë 21.01.2020 është tabela me numrin e nxënësve në datën 04.10.2019, ku numri i nxënësve rezulton 503 dhe numri i nxënësve për klasën e dytë është 64. Bashkëlidhur ka dërguar dhe shpërnguljet e 9 nxënësve nga të cilët vetëm 1 nxënës është në klasën e dytë dhe shpërngulja e të cilit mban datën 16.09.2019. Pra, nga data 19.09.2019, ku janë deklaruar 67 nxënës të regjistruar në klasën e dytë, deri në datën 18.10.2019 ku numri i nxënësve të klasës së dytë rezulton 62, referuar deklarimeve dhe dokumentacionit të dorëzuar, nuk ka asnjë shpërngulje të nxënësve të klasës së dytë. Referuar këtij dokumentacioni rezulton një klasë tepër e hapur në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.

Së dyti, lidhur me marrjen e masës ndaj ZVAP Roskovec, duke ju referuar raportit të vlerësimit nr. 491/2, datë 01.11.2019, të DRAP Fier, është konkluduar se duhet të bëhej studimi faktik i numrit të nxënësve të klasave dhe punonjësve, por nga të gjitha IA-të e inspektuara, si sqarohet edhe më sipër, vetëm në shkollën “Alush Grepcka” rezulton një numër më i lartë shkeljesh, si dhe hapja e një klase pa përmbushur kriterin e numrit të kërkuar të nxënësve të përcaktuar në Udhëzimin nr. 30, datë 12.09.2018, arsye për të cilën është rekomanduar masë disiplinore për drejtoreshën e shkollës dhe në vijim është marrë masa “Qortim”, nga Komisioni i Disiplinës.

Së treti, lidhur me provueshmërinë e grumbullimit të lekëve nga ana e ish-drejtoreshës, është pranuar se janë grumbulluar lekët, por për zhdëmtimin e dëmeve të shkaktuara në shkollë nga nxënësit. Në procesverbalin nr. 816/3, datë 09.10.2020 të Komisionit të Disiplinës në DRAP Fier, arsyetohet vendimi për marrjen e masës disiplinore “Paralajmërim për largim nga puna” ndaj M.K, vendim i cili bazohet edhe në faktin se janë konstatuar shkelje të Udhëzimit nr. 29, datë 25.03.2007 “Për grumbullimin, ruajtjen dhe përdorimin e të ardhurave nga prindërit e nxënësve të shkollave të arsimit parauniversitar”. Në këtë udhëzim përcaktohet mënyra e grumbullimit të të ardhurave nga prindërit e nxënësve, e cila nuk është respektuar nga M.K.

Gjithashtu, informohet se pas inspektimeve në katër shkolla në varësi të ZVAP Mallakastër, në shkollat ku grupet e punës kanë konstatuar shkelje të Udhëzimit nr. 29, datë 25.03.2007, përkatësisht me raport vlerësimi nr. 1029/1, datë 30.09.2021, raport vlerësimi nr. 1029/2, datë 30.09. 2021 dhe raport vlerësimi nr. 1029/3, datë 30.09.2021, është rekomanduar marrja e masës disiplinore për drejtuesit që janë gjetur në shkelje dhe nga ana e Komisionit të Disiplinës është proceduar me marrjen e masave disiplinore “Paralajmërim për largim nga puna”.

Së katërti, në DRAP Fier nuk disponohet dokumentacion për urdhrin dhe platformën e inspektimit të DPAP për shkollën “Alush Grepcka” dhe “Adem Vrapit” Roskovec”.

Në përgjigje të informacionit të dërguar nga DRAP Fier, ankuesja me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 112/3, datë 07.02.2022, në mes të tjerash informon se: “Së pari, numri i drejtuesve ishte në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, kreu II, pika C/3, pasi shkolla në shtator kishte të regjistruar 512 nxënës. Drejtoresha e ZVAP Roskovec në fund të muajit maj, ka kryer takim me mësueset e profilit gjuhë-letërsi, në zyrën e drejtorit të shkollës, ku i ka komunikuar mësuesve që asnjë të mos bëjë dosje për largim nga puna, ndërsa e ka ndaluar M.K të kryente procedurën me dosje për mësuesit e profilit gjuhë-letërsi. Kërkesës së ankueses për ta dhënë me shkrim këtë urdhrë, drejtuesja e ZVAP Roskovec i është përgjigjur se do të miratoj kuadrin. Miratimi i kuadrit u mjaftua vetëm me pagesat e mësuesve që bëri ZVAP-ja dhe orët që plotësuan mësuesit në shkollat e tjera. Me krijimin e ZVAP-ve kemi marrë urdhrë verbal nga drejtoresha e ZVAP Roskovec, për miratimin e kuadrit pranë kësaj zyre dhe në janar, ka dalë Urdhëri nr. 31, datë 28.01.2020, dhe në bazë të kreut X, neni 43, pika 2/a,b, është marrë miratimi i kuadrit nga ZVAP Roskovec dhe është bërë pagesa e mësuesve për muajin shtator.

Përsa i përket pretendimit të DRAP Fier për numrin e nxënësve për klasë, kjo është sqaruar pas një paqartësie që është bërë. Shkolla “Alush Grepcka” është shkollë qyteti dhe me numër të lartë nxënësish për klasë. Në fillim të vitit ka lëvizje të nxënësve dhe numri është i ndryshueshëm, edhe brenda ditës. Kishim nxënës të cilët erdhën nga jashtë shtetit pa dokumente shkolle dhe pas sqarimit me ZVAP-në, nxënësit janë pranuar në shkollë, pasi ishin të arsimit fillor. Ditën tjetër nxënësit u larguan përsëri pa tërhequr dokument nga shkolla. Kjo ka ndikuar në lëvizjen e numrit të nxënësve. Në bazë të Udhëzimit 30/2018, nëndrejtoresha është në pozicionin e sekretares së shkollës dhe plotëson dokumentet e pranimit dhe largimit të nxënësve. Ditën që ka kërkuar DRAP-i informacion për numrin e nxënësve, ka kontaktuar në telefon me nëndrejtoreshën dhe ka dhënë numrin e nxënësve që i ka dhënë ajo. Ky problem është sqaruar me DRAP-in.

Së dyti, asnjë nga mësuesit apo drejtuesit nuk kanë kërkuar apo grumbulluar lekë nga nxënësit. Kjo është vërtetuar dhe nga grupi i inspektimit nga DPAP Tiranë, ku në shkresën nr. 3530/7, datë 08.01.2021, fq. 6, treguesi 1: “grupi i punës u vu në dijeni se shkolla nuk grumbullon kontribute në vlerë monetare nga prindërit prej dy vitesh, por pranon dhurime në mallra ose në shërbime prej tyre”. Gjithashtu në raport vlerësimin e DRAP Fier nr. 494/1, datë 10.09.2020, fq. 3, nxënësit pasi janë marrë në pyetje nga grupi i inspektimit, nuk janë shprehur se në shkollë u

është kërkuar lekë për dëftesat. Nxënësit e klasave të nënta e kishin ditën e parë të kthimit në shkollë, pas pandemisë dhe kishin organizuar mes tyre rregullimin e klasave, pa dijeninë e mësuesit kujdestar apo të drejtorisë. Si fillim e kuptova se mësuesja M.K, që kishte klasën në kujdestari në të cilën ishte dëmtuar dera e klasës, po zhdëmtonte dëmin (rregullimin e derës). Ne jemi vënë në dijeni më vonë për veprimin dhe e kemi ndaluar si veprim. Unë jam në dijeni për shkolla në varësi të DRAP Fier të cilët kanë grumbulluar lekë nga prindërit e nxënësve në kundërshtim me Udhëzimin 29/2007 dhe DRAP Fier nuk ka masa në bazë të udhëzimeve për shkeljet”.

Në vijim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me shkresat nr. 112/1 dhe nr. 112/2, datë 03.02.2022, i është drejtuar me kërkesë për informacion, DPAP-së dhe DRAP-it Fier.

DPAP me shkresën nr. 140/1, datë 09.02.2022, në mes të tjerash informon se: “Vlerësimi i shkollës 9-vjeçare “Alush Grepcka” dhe gjimnazit “Adem Vrapit” në varësi të ZVAP Roskovec është realizuar në zbatim të urdhërit të DPAP nr. 399, datë 15.12.2020, si dhe platformës së vlerësimit me nr. 3530/1, datë 15.12.2020. Urdhëri dhe platforma e vlerësimit i është referuar bazës ligjore mbi të cilën është krijuar dhe funksionon DPAP-ja, si dhe legjislacionit në fuqi në fushën e arsimit parauniversitar.

Grupi i punës i përcaktuar për vlerësim në shkollën 9-vjeçare “Alush Grepcka” Roskovec është paraqitur me urdhërin dhe platformën e vlerësimit në ambientet e institucionit dhe ka filluar procedurën e vlerësimit. Gjatë këtij procesi grupi i punës ka shqyrtuar dokumentacionin shkollor dhe ka marrë me vete kopje të dokumentave të cilat janë konsideruar të nevojshme për hartimin e raportit të vlerësimit, si dhe ka mbajtur një procesverbal i cili është firmosur nga grupi i punës dhe nga M.K, si drejtuese e institucionit arsimor. DPAP me shkresën nr. 3530/3, datë 22.12.2020, ka dërguar në shkollën “Alush Grepcka”, draft raportin e vlerësimit duke specifikuar dhe afatet kohore për observacionet e mundëshme nga ana e drejtorisë së shkollës.

Drejtorja e shkollës “Alush Grepcka”, me shkresën nr. 308, datë 31.12.2020 ka dërguar në DPAP observacionet në lidhje me gjetjet dhe konstatimet në draft raportin e vlerësimit duke theksuar në fund të këtij dokumenti se: “Vërejtjet e cituara nga ana Juaj qëndrojnë. Mangësitë që ndodhen në dokumentacionin dhe dokumentat e munguara do ti plotësojmë dhe do ti rregullojmë në ditët në vazhdim”. Pas shqyrtimit të observacioneve grupi i punës ka hartuar raportin përfundimtar të vlerësimit i cili është dërguar në shkollën “Alush Grepcka”, me shkresën nr. 3530/7, datë 08.01.2021. Në raportin përfundimtar në funksion të gjetjeve /grykimeve dhe konkluzioneve të arritura janë vendosur dhe rekomandime për drejtorinë e shkollës, ZVAP Roskovec dhe DRAP Fier.

Përsa i përket masës disiplinore “Qortim” të dhënë ndaj drejtorit të shkollës “Alush Grepcka”, bëjmë me dije se për shfuqizimin e aktit administrativ nr. 5, datë 28.01.2020, M.K, duhet ti drejtohej organit kolegjal (komisionit të disiplinës në DRAP Fier) që ka dhënë këtë masë disiplinore”.

Me shkresën protokolluar me tonën, nr. 239, datë 02.02.2022, Kryetari i Shoqatës “Arëmënji di Albania” në mes të tjerash ka informuar se, M.K është aktiviste e shoqatës së tyre, dega Fier dhe aktiviteti i saj konsiston në promovimin dhe ruajtjen e vlerave etnike, kulturore, trashëgimore dhe fetare të komunitetit të Armanëve (vlllehëve) të Shqipërisë.

Në përgjigje të informacionit të dërguar nga DPAP, ankuesja me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 112/5, datë 07.03.2022, në mes të tjerash informon se: “Grupi i punës nga DPAP, me Urdhërin nr. 399, datë 15.12.2020 dhe platformën e vlerësimit nr. 3530/1, datë 15.12.2020, është paraqitur në drejtorinë e shkollës “Alush Grepcka” me datë 16.12.2020, kur si rregull, ditë më parë duhet të kishin dërguar urdhërin dhe platformën e inspektimit. Grupi i punës kreu inspektimin vetëm në datë 16.12.2020 dhe kërkoi vënien në dispozicion për rreth tre orë kohë, jo vetëm të dokumentacionit që përmbante platforma, por dhe dokumentacione të tjera jashtë platformës. Në datën 16.12.2020, ditë e mërkurë, si drejtuese kisha 3 orë mësim, ndërsa nëndrejtoresha B.P, kishte 2 orë mësim. Grupi i punës nuk na lejoi të dilnim nga drejtoria as për të komunikuar me mësuesin e shërbimit javor, përgjegjës për mbarëvajtjen e mësimit, të shikonte mundësinë e zëvendësimit të orëve të mësimit në klasat në të cilat në kishim mësim. Nxënësit jo vetëm humbën orën e mësimit por nuk kishin patur as kujdestar në klasë për të menaxhuar sjelljet e tyre. Grupi i punës ka ushtruar dhunë psikologjike në drejtori duke ngritur zërin dhe në një rast duke më akuzuar se plotësova në praninë e tyre formularin e orëve të vëzhgimit të mësuesve. Të hutuar nga presioni që ushtronte grupi i punës dhe kërkimi i dokumentave në një kohë të shkurtër nuk arritëm të vinim në dispozicion gjithë dokumentacionin e kërkuar. Plani afatmesëm dhe plani vjetor të cilat i kisha dorëzuar të rregullta në ZVAP Roskovec për miratim, dhe i kisha tërhequr nga ZVAP-ja, grupi i punës dy ditë pasi i kisha tërhequr, konstaton se plani afatmesëm kishte mungesë të faqeve. Përsa i përket procesverbaleve të dhurimeve nga kujdestarët e fëmijëve çdo mësues kujdestar kishte procesverbalet e klasave kujdestari, por grupi i punës kërkonte këto procesverbale të ishin si dokument në drejtori. Nuk kishim dijeni se këto procesverbale duhej ti kishim dhe në drejtori. Rregulloren e brendshme të shkollës e kishim hartuar duke ndjekur procedurat përkatëse, të firmosur nga kryetari i bordit të shkollës dhe afishuar në këndin e shkollës, por grupi i punës kërkonte dhe një kopje të dytë dhe grupi i punës nuk e quajti të plotësuar si rregullore, pasi kërkonte rregulloren Tip. Grupi i punës nuk pëlqeu formatet që përdorte drejtoria për vlerësimin e mësuesve pasi i quajti model i vjetër. Grupit të punës i është vënë në dispozicion planifikimi për muajt shtator-dhjetor dhe jo tetor-nëntor si e përmend në shkresën përcjellëse. Duke u nisur nga të gjitha sa përmenda më sipër, dhe mënyrën si kishte reaguar, më parë DRAP Fier, nuk dëshiroja të acaroja marrëdhëniet. Në observacion kam bërë kundërshtimet e mia, por edhe kam përmendur që do ti plotësojmë dokumentat e munguara. Dokumentat e tjera grupi i punës nuk i pëlqeu në formatin që kishim bërë ne. Nga komunikimi i ashpër dhe presioni që ushtruan përfaqësueset e grupit të punës së DPAP-së në drejtori, mosdërgimi i platformës, ardhja e befasishme, mungesa e disa faqeve të planit afatmesëm pas marrjes nga ZVAP Roskovec, mungesa e raportit vjetor në ZVAP Roskovec, më lë të kuptoj se ardhja e grupit të punës ishte e qëllimshme dhe në bashkëpunim me ZVAP Roskovec”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “*Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre*”.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: “*Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij*”.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.*”, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në etni apo në gjendjen martesore, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim.

DRAP Fier është krijuar me datë 20.05.2019 bazuar në Vendimin nr. 99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”. Bazuar në pikën 11 të kësaj VKM, përcaktohet që: “*Drejtorët e Drejtorive*

Rajonale emërojnë drejtorët e institucioneve arsimore publike (IAP), sipas udhëzimit përkatës të Ministrisë". Në këtë kontekst, si dhe bazuar në kompetencat e tjera sipas përcaktimeve të kësaj VKM-je, shihet qartë që shumica e kompetencave të ish-DAR i kanë kaluar strukturave të reja të krijuara, DRAP-eve, përfshirë edhe kompetencën për të emëruar dhe liruar nga detyra drejtorët e IAP-ve.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Referuar Librezës së Punës së M.K, rezulton se ka filluar punë si mësuese në shkollën Ngjeqar, në datë 03.09.1990. Në datë 23.09.1999 është transferuar në shkollën 8-vjeçare "Alush Grepcka" Roskovec dhe me Vendimin nr. 16, datë, 05.11.2018, është emëruar në detyrën e drejtorit të përkohshëm deri në përfundim të procedurave të konkurrimit në shkollën 9-vjeçare "Alush Grepcka" Roskovec.

Bazuar në informacionin dhe provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se, me Vendimin nr. 5, datë 28.01.2020 "*Për marrjen e masës disiplinore*", Komisioni i Disiplinës i DRAP Fier, ka vendosur dhënien e masës disiplinore "*Qortim*", për M.K, për arsye se nuk ka shpërndarë ngarkesën mësimore sipas Udhëzimit nr. 30/2018, dhe numri i mësuesve, nuk ishte në përputhje me numrin e nxënësve.

Me Vendimin nr. 68, datë 09.10.2020, Komisioni i Disiplinës i DRAP Fier, ka vendosur dhënien e masës disiplinore "*Paralajmërim për largim nga puna*", për M.K, për kryerje të veprimeve në kundërshtim me Dispozitat Normative 2013, të Udhëzimit nr. 29, datë 25.03.2007 dhe Udhëzimit nr. 25, datë 25.07.2018.

Me Vendimin nr. 26, datë 04.03.2021, DRAP Fier, ka vendosur zgjidhjen e kontratës së punës të M.K, titullare në institucionin arsimor, shkollën 9-vjeçare "Alush Grepcka", ZVAP Roskovec, për të cilën ishte në fuqi masa "*Paralajmërim për largim nga puna*", për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore sipas rekomandimeve dhe përcaktimeve të raport vlerësimit të DPAP Tiranë me nr. 3530/8, datë 08.01.2021.

Ankuesja pretendon se me veprimet e tyre, ZVAP Roskovec dhe DRAP Fier e kanë diskriminuar për shkak të etnisë dhe gjendjes shoqërore, duke e larguar nga puna si drejtoreshë dhe duke i mosofruar punë si mësuese, në kundërshtim me ligjin.

- *Lidhur me masën disiplinore "Qortim" të marrë ndaj ankuseses me Vendimin nr. 5, datë 28.01.2020, të DRAP Fier.*

Në nenin 54, të ligjit nr. 69/2012 "*Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar, parashikohet se drejtori i institucionit arsimor: "*1. Drejtori drejton veprimtarinë e institucionit arsimor. 2. Drejtori i institucionit arsimor, publik ose privat, është përgjegjës për: a) zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij; b) c)..... ç) menaxhimin e personelit dhe krijimin e kushteve për zhvillimin profesional të punonjësve të*

institucionit. 3. Drejtori i institucionit arsimor publik kryen edhe këto detyra: a) menaxhon institucionin, përfshirë edhe menaxhimin financiar; b); c)..... ”.

Në nenin 121 të Dispozitave Normative për sistemin arsimor parauniversitar, parashikohen masat disiplinore për drejtuesit e institucionit arsimor, si më poshtë: *1. Titullari i DAR/ZA-së ngre komisionin e disiplinës, që shqyrton masën disiplinore për drejtorin e institucionit arsimor. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët janë përgjegjësit e sektorëve dhe specialistë të caktuar nga titullari. 2. Komisioni i disiplinës vendos masën disiplinore për drejtorin e institucionit, kur konstaton: a) shkelje të dispozitave të Kodit të Punës ose LAPU, të akteve të tjera nënligjore dhe të DN-së; b) shkelje të etikës e të sjelljes në institucion; c) moskryerje të detyrave; ç) përsëritje të rezultateve të ulëta të shkollës në provimet kombëtare dhe në renditjen e shkollave të suksesshme. 3. Masat që komisioni i disiplinës vendos për drejtorin, janë: a) qortim; b) vërejtje; c) paralajmërim për largim nga puna. 4. Komisioni i disiplinës shqyrton marrjen e masave disiplinore ndaj drejtorit të institucionit arsimor, me kërkesën me shkrim të specialistëve të DAR/ZA-së ose të ekipit të inspektimit të ISHA-së, ose të mësuesve, nxënësve të institucionit, prindërve të nxënësve dhe çdo personi që ka hyrë me leje në institucion ”.*

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në RSH”, të ndryshuar, është miratuar Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, në të cilin në Kreun II, përcaktohet numri i nxënësve për klasë, numri i drejtuesve dhe norma mësimore javore e mësuesve dhe drejtuesve. Në pikën A/2/b), përcaktohet se: “Ndarja e klasave paralele të bëhet sipas këtij rregulli: b) Tri klasa paralele, kur numri i nxënësve është 66-99”. Në pikën C/3, përcaktohet se: Numri i drejtuesve. “Kur numri i nxënësve është 501-900, emërohen dy nëndrejtorë shkolle”, ndërsa në pikën D/3, përcaktohet se: “Mësuesi i gjuhës shqipe, i gjuhës së huaj, i matematikës, i fizikës, i biologjisë, i kimisë, i informatikës, i historisë, i gjeografisë, mësuesi në shkollat e arsimit special: 20 orë në javë”.

Referuar Raportit të Vlerësimit nr. 491/2, datë 01.11.2019, të grupit të inspektimit të ngritur nga DRAP Fier, mbi zbatimin e bazës ligjore për punësimin, ngarkesën mësimore, numrin e nxënësve për klasë në ZVAP Roskovec dhe IA-ve në varësi të saj, rezulton se grupi i inspektimit në datë 18.10.2019 ka zhvilluar inspektimin në ZVAP Roskovec dhe në institucionet arsimore në varësi të saj. Në përfundim, grupi i inspektimit, bazuar në gjetjet e inspektimit, në mes të tjerash ka rekomanduar dhënien e masës disiplinore, drejtueses së shkollës “Alush Grepcka”, pasi nuk ka zbatuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

ZVAP Roskovec me shkresën datë 19.11.2019, ka informuar shkollën “Alush Grepcka”, se në raportin e inspektimit të DRAP Fier është konstatuar se: 1. Numri i drejtuesve në shkollë nuk është në përputhje me Udhëzimin nr. 30/2018. Shkolla ka 498 nxënës dhe dy nëndrejtorë. 2. Numri i mësuesve është më i lartë se numri i orëve mësimore, në profilin gjuhë-letërsi, pasi janë 45 orë dhe janë 4 mësues dhe 1 nëndrejtor. 3. Në shkollë ka mësues të edukimit muzikor pa profilin përkatës. Interpretimi i këtyre kontratave është bërë nga DRAP Fier dhe vënë në dijeni nga ZVAP Roskovec, shkolla nuk e ka zbatuar. 4. Grupi i inspektimit konstatoi se dosjet e

mësuesve nuk ishin të përditësuara, mungonin kontratat e punës, librezat e punës dhe diplomat ishin të pa noterizuara.

Shkolla “Alush Grepcka” me shkresën nr. 8, datë 21.01.2020, ka informuar DRAP-in Fier me numrin e nxënësve të regjistruar në muajin shtator 2019 (512 nxënës), numrin e nxënësve në datën 04.10.2019 (503 nxënës), numrin e nxënësve të larguar nga datë 16.09.2019 – 04.10.2019 (9 nxënës), si dhe shpërndarjen e orëve mësimore të mësuesve të lëndës gjuhë shqipe.

Referuar procesverbalit nr. 41/2, datë 27.01.2020, të Komisionit të Disiplinës të DRAP Fier, rezulton se komisioni, pasi mori në shqyrtim raportin e vlerësimit nr. 491/2, datë 01.11.2019 dhe dëgjuesën e drejtoreshës, M.K, konstatoi dhe njëherë shkeljet e bëra në raportin e vlerësimit dhe në përfundim vendosi unanimisht që ndaj M.K të jepej masa disiplinore “Qortim”.

DRAP Fier, me Vendimin nr. 5, datë 28.01.2020 “Për marrjen e masës disiplinore”, vendosi dhënien e masës disiplinore “Qortim”, për drejtoreshën e shkollës “Alush Grepcka”, M.K, për arsytet se: “2. Nuk ka shpërndarë ngarkesën mësimore sipas Udhëzimit nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat mësimore në institucionin arsimor parauniversitar”. 3. Numri i mësuesve që duhen në IA nuk është në përputhje me numrin e nxënësve, pasi numri i mësuesve është më i lartë se numri i orëve mësimore në profil (profili gjuhë - letërsi në 45 orë ka 4 mësues dhe 1 nëndrejtor). 5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi brenda 10 ditëve”.

Ankuesja ka pretenduar para Komisionerit, se numri i drejtuesve ishte në përputhje me Udhëzimin nr. 30/2018, pasi shkolla në shtator kishte të regjistruar 512 nxënës, drejtoresha e ZVAP Roskovec në fund të muajit maj e ka ndaluar M.K të kryente procedurën me dosje për mësuesit e profilit gjuhë-letërsi dhe përse i përket numrit të nxënësve për klasë, kjo është sqaruar pas një paqartësie që është bërë, pasi në fillim të vitit shkollor ka pasur lëvizje të nxënësve të cilët erdhën nga jashtë shtetit pa dokumente shkolle dhe ditën tjetër nxënësit u larguan përsëri pa tërhequr dokument nga shkolla.

Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara, Komisioneri vlerëson se, ankuesja në cilësinë e drejtoreshës së shkollës “Alush Grepcka”, nuk ka arritur të justifikojë shpërndarjen e ngarkesës mësimore dhe numrin e nxënësve, as para grupit të inspektimit dhe as para komisionit të disiplinës. Justifikimi i saj, nuk është i mbështetur në dokumentacionin shkollor, por ngelet në kuadër të deklarimeve dhe të pambështetura në prova.

Referuar dokumentacionit të administruar, rezulton se M.K, nuk e ka ankimuar masën disiplinore të DRAP-it Fier.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga DRAP Fier, rezulton se nga ana e këtij institucioni është mbajtur i njëjti qëndrim dhe në rastin e trajtimit të raportit të vlerësimit nr. 510/3, datë 18.11.2019, të mbajtur në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Mihal Nako”, Fierseman, ZVAP Divjakë. Referuar procesverbalit nr. 40/1, datë 10.01.2020, të Komisionit të Disiplinës të DRAP Fier, rezulton se komisioni pasi mori në shqyrtim raportin e vlerësimit nr. 510/3, datë 18.11.2019 dhe dëgjuesën me drejtorin R.Th, konstatoi se drejtori i IA “Mihal Naka”, nuk ka shpërndarë

ngarkesën mësimore dhe nuk ka kryer të plotë lëvizjen paralele të detyruar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe për këtë arsye komisioni i disiplinës unanimitisht ka vendosur, që ndaj drejtorit R.Th të jepej masa disiplinore “Qortim”.

Sa më sipër rezulton se, inspektimi dhe vlerësimi i zbatimit të legjislacionit të arsimit nga ana e ZVAP-ve dhe institucioneve arsimore, në varësi të DRAP Fier, është një praktikë që ndiqet në vijimësi dhe nuk është një praktikë që është zbatuar vetëm për shkollën “Alush Grepcka” Roskovec, pasi nga ana e Komisionit të Disiplinës dhe të DRAP Fier, është ndjekur e njëjta procedurë dhe është mbajtur qëndrim i njëjtë, si në trajtimin e shkeljes së konstatuar të ankueses dhe të drejtuesit të shkollës “Mihal Naka”.

- *Lidhur me masën disiplinore “Paralajmërim për largim nga puna” të marrë ndaj ankueses me Vendimin nr. 68, datë 09.10.2020, të DRAP Fier.*

Në nenin 106 të Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, të miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 të MAS, parashikohen masat disiplinore për drejtuesit e institucionin arsimor, si më poshtë: *1. Titullari i DRAP ngrre komisionin e disiplinës, që shqyrton masën disiplinore për drejtorin e IA-së. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët janë përgjegjësit e sektorëve dhe specialistë të caktuar nga titullari. 2. Komisioni i disiplinës në DRAP vendos masën disiplinore për drejtorin e institucionit, kur konstaton: a) shkelje të dispozitave të Kodit të Punës ose LAPU-së, të akteve të tjera nënligjore dhe të Rregullores; b) shkelje të etikës e të sjelljes në institucion; c) moskryerje të detyrave, sipas përshkrimit të punës; ç) përsëritje të rezultateve të ulëta të shkollës në provimet kombëtare. 3. Masat që komisioni i disiplinës vendos për drejtorin, janë: a) qortim; b) vërejtje; c) paralajmërim për largim nga puna. 4..... 5. Komisioni i disiplinës shqyrton marrjen e masave disiplinore ndaj drejtorit të IA-së, me kërkesën me shkrim të DRAP-it ose të ekipit të monitorimit e vlerësimit, ose të mësuesve, të nxënësve të institucionit, të personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve dhe çdo personi që ka hyrë me leje në institucion”.*

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në RSH”, të ndryshuar, është miratuar Udhëzimi nr. 25, datë 25.07.2018 i MAS “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”. Në Kreun 5, përcaktohen detyrat e bordit, të cilat janë: *“1. Bordi ka për detyrë: a) të miratojë planin afatmesëm dhe atë vjetor të institucionit; b) të miratojë planin e shpenzimeve të institucionit arsimor për fondet, të cilat sigurohen nga institucioni; c).....; d).....; e).....; f).....; g) të shqyrtojë raportin vjetor financiar të institucionit; h).....; i)..... j) të përfaqësojë shqetësimet e institucionit arsimor te qytetarët, tek tatimpaguesit dhe te prindërit në komunitet; k).....; l); m)..... . 2. Bordi përpiqet për të siguruar kontribute të ligjshme vendase ose të huaja për mbarëvajtjen e institucionit”.*

Në Udhëzimin nr. 29, datë 25.09.2007 “Për grumbullimin, ruajtjen dhe përdorimin e të ardhurave nga dhurimet nga prindërit e nxënësve të shkollave të arsimit parauniversitar”, në pikën 5 të kreut, “Për dhurimet në para ose në natyrë shkollës, klasës ose mësuesit lëndor me iniciativën e dhuruesit”, përcaktohet se: *“5. Kur pjesëtarë të komunitetit bëjnë dhurime në*

mallra dhe/ose shërbime për shkollën ose klasën ose lëndën me nismën e tyre, këto dhurime regjistrohen në një libër të veçantë dhe njëkohësisht njoftohet DAR/ZA”, ndërsa në kreun, “Raportimi dhe Kontrolli”, përcaktohet se: “1. Për të gjitha materialet e blera ose shërbimet e kryera në shkollë në sajë të kontributit të prindërve, drejtori i shkollës raporton me shkresë të pocaçme te DAR/ZA. 2. 3. DAR/ZA ushtron të drejtën e kontrollit mbi mënyrën e përdorimit të lekëve si dhe mbi mirëmbajtjen e materialeve apo shërbimeve të kryera në shkolla nga dhurimet”.

Referuar draft raportit të vlerësimit nr. 453/3, datë 30.07.2020, të grupit të inspektimit të ngritur nga DRAP Fier, për verifikimin e dokumentacionit në ruajtje të përhershme në shkollën “Alush Grepcka”, rezulton se grupi i inspektimit në datë 02.07.2020 ka zhvilluar inspektimin në këtë shkollë. Në përfundim, grupi i inspektimit ka konkluduar se: “Nga zbatimi jo i drejtë dhe jo i saktë i akteve ligjore në fuqi, janë krijuar problematika në lidhje me ankesat e qytetarëve, të cilët kanë të drejtë të pajisen me dokumentacionin kërkuar. Si rrjedhojë pretendimet e drejtueses se ky problem nuk është krijuar prej saj, por është i trashëguar ndër vite nuk e përlligj shmangien nga detyra funksionale, pasi M.K, duhet të kishte zhvilluar gjithë procedurat ligjore, duke nisur me raportimin shkresor pranë ish DAR Fier dhe ZVAP Roskovec, sapo kishte marrë detyrën si drejtuese e institucionit arsimor apo në fillim të vitit shkollor 2019-2020, me qëllim zgjidhjen e problematikave të hasura ndër vite në këtë institucion arsimor”.

Referuar procesverbalit nr. 816/3, datë 09.10.2020, të Komisionit të Disiplinës të DRAP Fier, rezulton se komisioni, pasi mori në shqyrtim raportin e vlerësimit nr. 449/4, datë 10.09.2020 dhe nr. 760, datë 22.09.2020, mbi zbatimin e akteve ligjore për dokumentacionin në ruajtje të përhershme, si dhe pas dëgjësës me drejtoreshën e shkollës, M.K, dhe dokumentacionin e dërguar nga ana e saj me shkresën nr. 816/2, datë 06.10.2020, ka vendosur unanimisht që ndaj M.K të jepej masa disiplinore “Paralajmërim për largim nga puna”.

DRAP Fier, me Vendimin nr. 68, datë 09.10.2020 “Për marrjen e masës disiplinore”, vendosi: “1. Ti japë M.K me detyrë drejtore në shkollën “Alush Grepcka”, masën disiplinore “Paralajmërim për largim nga puna”, për kryerje të veprimeve në kundërshtim me e Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH”, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 29, datë 25.09.2007 “Për grumbullimin, ruajtjen dhe përdorimin e të ardhurave nga dhurimet nga prindërit e nxënësve të shkollave të arsimit parauniversitar” dhe Udhëzimin nr. 25, datë 25.07.2018 i MAS “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”, referuar trajtimit të situatës në procesverbalin, datë 09.10.2020, sipas raportit të vlerësimit nr. 449/4, datë 10.09.2020 dhe nr. 760, datë 22.09.2020. 2. Ky vendim i shtrin efektet nga data 09.10.2020-09.10.2021. 3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi brenda 5 ditëve”.

Ankuesja në shkresën e protokolluar me tonën me nr. 112/3, datë 07.02.2022, në mes të tjerash ka pretenduar se nuk janë grumbulluar lekë nga nxënësit për shpërndarjen e dëftesave, por informon se pa dijeninë e mësuesit kujdestar dhe drejtorisë së shkollës, nxënësit e klasave të nënta kishin organizuar mes tyre rregullimin e klasave. Gjithashtu, M.K informon se është në

dijeni dhe për shkolla të tjera në varësi të DRAP Fier, të cilët kanë grumbulluar lekë nga prindërit e nxënësve në kundërshtim me Udhëzimin 29/2007, dhe DRAP Fier nuk ka masa në bazë të udhëzimeve për shkeljet.

Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara, Komisioneri vlerëson se, ankuesja në cilësinë e drejtores së shkollës “Alush Grepcka”, nuk ka arritur të argumentojë dhe justifikojë mbajtjen sipas dispozitave ligjore të dokumentacionit shkollor, menaxhimit të institucionit dhe përdorimit të të ardhurave të institucionit, as para grupit të vlerësimit dhe as para Komisionit të Disiplinës. Justifikimi i M.K, se nuk ka pasur dijeni për mungesa amzash dhe nuk kishte dijeni për rregullimin e klasave me iniciativë të nxënësve, është i pambështetur në fakte dhe prova, por ngelet në kuadër të deklarimeve të saj.

Referuar dokumentacionit të administruar, rezulton se M.K, nuk e ka ankimuar masën disiplinore “*Paralajmërim për largim nga puna*” të dhënë nga DRAP-it Fier.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga DRAP Fier, rezulton se nga ana e këtij institucioni është mbajtur i njëjti qëndrim dhe në rastin e trajtimit të raporteve të vlerësimit nr. 1029/1, nr. 1029/2, dhe nr. 1029/3, datë 30.09.2021, të mbajtur në Shkollat 9-vjeçare: “Besëlidhja”, “Ismail Klosi” dhe “5 Shkurti” të ZVAP Mallakastër. Rezulton se grupi i vlerësimit i DRAP Fier, në mes të tjerash ka gjetur në shkelje drejtuesit e këtyre shkollave në lidhje me menaxhinin e të ardhurave duke mos zbatuar asnjë pikë të Udhëzimit nr. 29, datë 25.09.2007 “*Për grumbullimin, ruajtjen dhe përdorimin e të ardhurave nga dhurimet nga prindërit e nxënësve të shkollave të arsimit parauniversitar*”, dhe në përfundim ka rekomanduar marrjen e masave disiplinore për këto drejtues⁵.

Sa më sipër rezulton se, inspektimi dhe vlerësimi i zbatimit të legjislacionit të arsimit nga ana e ZVAP-ve dhe institucioneve arsimore, në varësi të DRAP Fier, është një praktikë që ndiqet në vijimësi dhe nuk është një praktikë që është zbatuar vetëm për shkollën “Alush Grepcka” Roskovec, pasi nga ana e DRAP Fier, është ndjekur e njëjta procedurë dhe është mbajtur qëndrim i njëjtë, si në trajtimin e shkeljes së konstatuar të ankueses dhe të drejtuesve të shkollave: “Besëlidhja”, “Ismail Klosi” dhe “5 Shkurti”.

- *Lidhur me masën disiplinore “Për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës” të marrë ndaj ankueses me Vendimin nr. 26, datë 04.03.2021, të DRAP Fier.*

Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, me Urdhërin nr. 399, datë 15.12.2020 ka ngritur grupin e punës për verifikimin e procedurave të ndjekura për hartimin e planit afatmesëm, planit vjetor, rregulloren e brendshme, raportin vjetor, shpërndarjen e ngarkesës mësimore, ngritjen e bordit, grumbullimin dhe administrimin e të ardhurave në institucionet arsimore “Alush Grepcka” dhe “Adem Vrapit” Roskovec.

⁵ Referuar shkresës nr. 107, datë 14.01.2022 të DRAP Fier: “*Bazuar në rekomandimet e raporteve të vlerësimit ku është rekomanduar marrja e masave administrative ndaj drejtorëve të cilët janë gjetur në shkelje, nga Komisioni i Disiplinës të DRAP Fier, janë ndjekur procedurat ligjore për marrjen e masave në propozicion me shkeljet e konstatuara*”.

Grupi i punës i përcaktuar për vlerësim në shkollën 9-vjeçare “Alush Grepcka” Roskovec është paraqitur në datë 16.12.2020 në ambientet e shkollës dhe ka filluar procedurën e vlerësimit. DPAP me shkresën nr. 3530/3, datë 22.12.2020, ka dërguar në shkollën “Alush Grepcka”, draft raportin e vlerësimit duke specifikuar dhe afatet kohore për observacionet e mundëshme nga ana e drejtorisë së shkollës.

Drejtoria e shkollës “Alush Grepcka”, me shkresën nr. 308, datë 31.12.2020 ka dërguar në DPAP observacionet në lidhje me gjetjet dhe konstatimet në draft raportin e vlerësimit duke theksuar në fund të këtij dokumenti se: *“Vërejtjet e cituara nga ana Juaj qëndrojnë. Mangësitë që ndodhen në dokumentacionin dhe dokumentat e munguara do ti plotësojmë dhe do ti rregullojmë në ditët në vazhdim”.*

Me shkresën nr. 3530/7, datë 08.01.2021, DPAP ka dërguar pranë institucioneve përkatëse raportin e vlerësimit përfundimtar të shkollës “Alush Grepcka”.

Në raportin përfundimtar DPAP, ka rekomanduar që shkolla “Alush Grepcka” të: *“Të rihartojë planin afatmesëm, planin vjetor dhe rregulloren e brendshme të IA-së. Të hartojë raportin vjetor të IA-së. Të riorganizojë procedurën e zgjedhjes së bordit të shkollës. Stafit drejtues të hartojë planin vjetor/mujor/javor për vlerësimin e procesit mësimor. Dhurimet nga komuniteti, prindërit e shkollës në mallra/shërbime të inventarizohen sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr.29, datë 25.09.2007, “Për grumbullimin, ruajtjen dhe përdorimin e të ardhurave nga dhurimet nga prindërit e nxënësve të shkollave të arsimit parauniversitar”. Ndarja e orëve mësimore të mësuesit të shkollës të bëhet në përputhje të plotë me përcaktimet në shtojcën e Udhëzimit nr. 30, datë 12.09.2013 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, ndërsa DRAP-it Fier i ka rekomanduar që të marrë masë për drejtorin e shkollës “Alush Grepcka”.*

Në vijim të rekomandimit të DPAP-së, DRAP Fier me shkresën nr. 45/1, datë 14.01.2021 *“Njoftim për zgjidhjen e njëanshme të kontratës së punës”*, ka njoftuar M.K për tu paraqitur në datë 21.01.2021, për të parashtruar arsyet e vendimit dhe për ti dhënë mundësinë ankueses që të shprehej lidhur me çështjen.

Ankuesja për arsye shëndetësore nuk është paraqitur në njoftimin e datës 14.01.2021 dhe 01.02.2021.

Me shkresën nr. 244, datë 22.02.2021 është njoftuar përsëri ankuesja për tu paraqitur në DRAP Fier në datë 26.02.2021. Në datë 26.02.2021 është mbajtur procesverbali i takimit mes palëve, në të cilin ankuesja nuk ka kundërshtuar gjetjet e raportit të vlerësimit të DPAP-së, por ka informuar DRAP-in Fier se ka kërkuar dorëheqjen nga posti i drejtorit dhe kalimin si mësuese.

Me Vendimin nr. 26, datë 04.03.2021 *“Për zgjidhejn e menjëhershme të kontratës së punës”*, DRAP Fier, ka vendosur zgjidhjen e kontratës së punës të M.K, titullare në institucionin arsimor “Alush Grepcka”, për të cilën ishte në fuqi masa *“Paralajmërim për largim nga puna”*.

DPAP ka mbajtur të njëjtin qëndrim dhe për drejtuesin e shkollës “Adem Vrapit” Roskovec, ku në bazë të gjetjeve të raportit të inspektimit nr. 3530/9, datë 22.01.2021, të DPAP-së kanë konstatuar shkelje në këtë shkollë dhe i kanë rekomanduar DRAP-it Fier, marrjen e masës disiplinore për drejtuesin e shkollës “Adem Vrapit. DRAP Fier me Vendimin nr. 289/3, datë 30.03.2021 ka marrë masën disiplinore “Qortim” për drejtuesin e kësaj shkolle.

Gjithashtu DRAP Fier, ka mbajtur të njëjtin qëndrim duke zgjidhur kontratën e punës dhe me drejtorin e shkollës 9-vjeçare “15 Tetori” Vlorë, pas shkeljeve të konstatuara nga ana e grupit të vlerësimit të DPAP-së, referuar raportit të inspektimit nr. 1282/1, datë 01.06.2020.

- *Lidhur me trajtimin e kërkesën për dorëheqje nga pozicioni i drejtores së shkollës “Alush Grepcka” të bërë nga M.K.*

Në pikën 3/1 të Kreut 10 të Udhëzimit nr. 13, datë 22.05.2019 *“Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Drejtuësit e DRAP-eve, nuk mund të pranojnë kërkesat për dorëheqje të drejtorëve dhe nëndrejtorëve të institucioneve arsimore, pa i sistemuar më parë në vende pune të lira dhe me ngarkesë të plotë brenda të njëjtës ZVAP-je, me përjashtim të rasteve kur drejtorët apo nëndrejtorët largohen nga sistemi arsimor sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk kanë 5 vite eksperiencë pune si drejtor/nëndrejtor apo mësues, apo nuk plotësojnë kriteret ligjore për të qenë mësues. Rastet e dorëheqjeve të drejtorëve dhe nëndrejtorëve i të IA-ve, me kërkesën për sistemim për mësues, i paraqiten menjëherë komisionit të lëvizjeve paralele në ZVAP, gjatë apo ndërmjet viteve mësimore, komisioni i cili ia propozon kërkesat drejtorit të institucionit arsimor ku lirohet vendi më i parë i punës.....”.*

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga palët rezulton se pas marrjes së njoftimit për zgjidhjen e njëanshme të kontratës së punës në datë 14.01.2021, M.K me shkresën nr. 15, datë 19.01.2021 drejtuar DRAP Fier, ka kërkuar dorëheqjen nga pozicioni si drejtuese e shkollës “Alush Grepcka”.

DRAP Fier me shkresën nr. 73/1, datë 02.03.2021 i është drejtuar me kërkesë për informacion ZVAP-së Roskovec dhe Komisionit të Lëvizjeve Paralele, në lidhje me disponimin e orëve të lira në profilin Histori dhe Gjeografi.

ZVAP-ja Roskovec me shkresën nr. 215, datë 04.03.2021 ka informuar DRAP Fier se në ZVAP Roskovec nuk ka asnjë kërkesë për orë të lira nga drejtuesit e shkollave për profilin Histori-Gjeografi.

Në vlerësim të korrespondencës së mësipërme rezulton, se edhe pse ka qenë në proces të zgjidhjes së kontratës së punës për shkaqe të arsyeshme me M.K, DRAP Fier e ka konsideruar mundësinë e kërkuar nga M.K, por ZVAP Roskovec nuk ka patur vende të lira në profilin histori dhe gjeografi, në mënyrë që ankuesja të mund të sistemohej si mësuese.

Në përfundim, Komisioneri gjatë analizës së informacionit dhe provave të sipërcituara, konstatoi se:

- Nga ana e DRAP Fier, janë ndjekur të gjithë procedurat dhe hapat, në mbështetje të akteve ligjore/nënligjore, për marrjen e masave disiplinore për ankuesen dhe M.K ka pasur informacionin e duhur për tu ankuar për këto masa disiplinore.
- DPAP dhe DRAP Fier, kanë mbajtur të njëjtin qëndrim, në raportet e vlerësimit, për konstatimin e shkeljeve të akteve ligjore dhe nënligjore të arsimit parauniversitar nga ana e drejtuesve të IA-ve, si dhe gjatë procesit të marrjes së masave disiplinore nga ana e Komisionit Disiplinor të DRAP-it Fier.
- Rezultoi që DRAP Fier ka ndjekur procedurën për vlerësimin e kërkesës për dorëheqje të bërë nga ankuesja;

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi”*.

Në nenin 12/1/c) të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimi e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Nga aktet e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, rezulton se ankuesja e ka kundërshtuar në gjykatë vendimarrjen e DRAP-it Fier, për zgjidhjen e kontratës së punës.

Në kërkesëpadinë drejtuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier, ankuesja ka kërkuar:

- Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen me 12 paga mujore bruto për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës;
- Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen me 3 paga mujore bruto për mosrespektim të afatit të njoftimit;

- Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen me 2 paga mujore bruto për mosrespektim të procedurës;
- Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen me 16 paga mujore bruto si shpërblim për vjetërsi pune.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me Vendimin nr. 62-2021-5427- (1105), datë 09.11.2021, ka vendosur: - Rrëzimin e padisë⁶.

Referuar vendimit të gjykatës, rezulton se gjykata në mes të tjerash ka arsyetuar se: “...*Shkaqet për të cilat është zgjidhur kjo marrëdhënie pune kanë qenë masat disiplinore që paditësja ka marrë gjatë ushtrimit të detyrës si drejtore e shkollës “Alush Grepcka” Roskovec. Në këto rrethana pretendimi i palës paditëse për dëmshpërblim me 1 vit pagë mujore për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme e të pajustificuar, sipas nenit 155 të Kodit të Punës, është i pabazuar ligjërisht dhe duhet të rrëzohet”.*

Në thelb, me këtë vendim, gjykata ka disponuar midis po atyre palëve dhe për të njëjtat pretendime, që ankuesja ka bërë objekt shqyrtimi dhe pranë Komisionerit. Gjykata ka vendosur rrëzimin e padisë së bërë nga M.K, lidhur me ligjshmërinë e konstatimit vendimit të zgjidhjes së kontratës së punës. Ndodhur në këto kushte, Komisioneri arrin në përfundimin se, nuk mund të arrijë në vlerësimin se ankuesja i është nënshtuar një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshëm për shkak se për të njëjtat palë, për të njëjtin objekt dhe të njëjtat veprime dhe mosveprime Gjykata është shprehur me vendim.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se DRAP Fier, nuk ka ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje të paligjshme nga ana e DRAP Fier, për shkakun e pretenduar nga ankuesja dhe për rrjedhojë nuk provohet se DRAP Fier ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

⁶ Vendimi nuk është i formës së prerë pasi, M.K, më Ankimin datë 13.12.2021, i është drejtuar Gjykatës së Apelit Vlorë.

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses M.K, në të drejtën për punësim, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier, për shkaqet e pretenduara prej saj.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA